




Financuar nga
Bashkimi Evropian



KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

KAPITULLI 23: GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE

ZBATIMI I LIGJIT TË RI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NË KONTEKSTIN E NEGOCIATAVE PËR KAPITULLIN 23: DIALOG ME SHOQËRINË CIVILE DHE SEKTORIN PRIVAT

15 korrik 2025

Xheko Imperial Hotel

10:00 - 13:00

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Lëvizja Europiane në Shqipëri kanë kënaqësinë t'ju ftojnë në takim e radhës së Grupit të Punës për Kapitullin 23: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore, që zhvillohet në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin Europian, e mbështetur nga Bashkimi Europian.

Grupi i Punës për Kapitullin 23 shërben si një hapësirë konsultimi dhe dialogu që mundëson përfshirjen e aktorëve jo-shtetërorë në procesin e negociatave, si përfaqësues të shoqërisë civile, hulumtues dhe lektorë, profesionistë të ligjit dhe aktorë të tjerë kyç. Qëllimi nuk është vetëm informimi mbi procesin, por edhe angazhimi aktiv i shoqërisë civile dhe grupeve të interesit për të dhënë rekomandime dhe komente mbi kuadrin ligjor dhe politikat e miratuara, si dhe për të ndjekur e monitoruar procesin e politikëbërjes në faza të ndryshme të tij.

Ky sesion i Grupit të Punës për Kapitullin 23 synon të bëjë bashkë **organizata të shoqërisë civile dhe aktivistë të të drejtave të njeriut, akademikë, profesionistë të ligjit, operatorë privatë dhe përfaqësues të medias** për tu informuar më gjerësisht mbi ligjin e ri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 124/2024 i miratuar në dhjetor 2024. Ky ligj ndër të tjera sjell disa risi dhe elemente inovatore që synojnë mbrojtje më të targetuar dhe gjithëpërfshirëse të të dhënave personale, duke bërë të mundur një harmonizim më të mire dhe me legjislacionin e Bashkimit Europian, e cila vjen në kuadër të procesit të negociatave dhe realizimit të kriterëve të ndërmjetme të vendosura për Kapitullin 23 në këtë nënfushë. Me rëndësi për tu diskutuar është dhe puna që po kryhet për miratimin e akteve nënligjore për një zbatim sa më efektiv të tij. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet shkëmbimit të praktikave të mira, me pjesëmarrjen e një eksperteje nga Sllovakia, e cila do të ndajë modele konkrete dhe përvoja të suksesshme nga konteksti i BE-së, me fokus procesin e zbatimit të GDPR.

Ju ftojmë të konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në: info@em-al.org


Mirëpresim pjesëmarrjen dhe përfshirjen tuaj aktive në këtë aktivitet!

Ky Sesion i Grupit të Punës për Kapitullin 23 zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", që po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Europian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Lirinë e Informacionit (CTFI)





Financuar nga
Bashkimi Evropian



KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

KAPITULLI 23: GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE

ZBATIMI I LIGJIT TË RI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

NË KONTEKSTIN E NEGOCIATAVE PËR KAPITULLIN 23: DIALOG ME SHOOËRINË CIVILE DHE SEKTORIN PRIVAT

15 korrik 2025

Xheko Imperial Hotel

10:00 - 13:00

10:00 - 10:30

Regjistrimi dhe Kafja e Mirëseardhjes

10:30 - 10:45

Përshëndetja e Takimit

Znj. **Blerta Nerguti**, Sekretare e Përgjithshme, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Z. **Gledis Gjipali**, Drejtor Ekzekutiv, Lëvizja Europiane në Shqipëri

10:45 - 11:10

Ligji i Ri për Mbrojtjen e të Dhënave: Çfarë Ndryshon dhe Si do të Zbatohet në Praktikë

- Prezantimi i risive të ligjit të ri (elementet inovatore por edhe sfidat në zbatim)
- Progresi në kuadër të procesit të negociatave dhe plotësimit të piketave të ndërmjetme për Kapitullin 23
- Puna për realizimin e akteve nënligjore – përfshirja e aktorëve jo-shtetërorë në procesin konsultues

Znj. **Blerta Nerguti**, Sekretare e Përgjithshme, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Znj. **Pjerina Mema**, Drejtore e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

11:10 - 11:40

Zbatimi në Praktikë i GDPR: Harmonizimi në Nivel Kombëtar dhe Roli i Aktorëve Jo Shtetërorë

- Sfidat në zbatimin e GDPR në nivel kombëtar dhe boshllëqet më të shpeshta në praktikë
- Roli i aktorëve jo shtetërorë në zbatimin dhe mbikëqyrjen e mbrojtjes së të dhënave personale
- Implikimet praktike të GDPR për sektorë të ndryshëm: minimizimi i të dhënave, e drejta për t'u harruar, DPIA, konsultimet paraprake, etj.

Znj. **Zuzana Motuzova**, Avokate dhe bashkëthemeluese e Motúzová & Lacko Law company/Slovakia

11:40 - 12:15

Diskutim Ndërveprues me lektorë, shoqëri civile, profesionistë të drejtësisë dhe aktorë të tjerë të përfshirë

12:15 - 13:00

Mbyllja e aktivitetit dhe kokteil rrjetëzimi

Ky Sesion i Grupit të Punës për Kapitullin 23 zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", që po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Europian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Lirinë e Informacionit (CTFI)

